



Planuar / Doretuar Priljefto/Prodato Received/Delivery	26.09	2022	2	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SHKIMSHICK	5687/2022		114	



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr. 698/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani kryetar Ardita Haxhnikaj -Demi dhe Jeton Koca anëtarë, me Rushit Kajtazi -Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.698/2022, të datës 11.08.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi nga Komuna e Prishtinës, kundër organit të punësimit Agjencia Kosovare e Privatizimit, në çështjen juridike " kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, nenin 47, 48 paragrafi 1 dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrativ dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 26.09.2022, mori këtë.

V E N D I M

I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.147/2022, të datës 11.08.2022 të parashtruar nga ankuesi

II. MBETET në fuqi, Vendimi i Bordit të Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit i datës 04.07.2022.

A r s y e t i m

Kryesuesi i Bordit të Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit, me vendimin Nr. Ref. BD -72/3 të datës 25.02.20216,ka shkarkuar ankuesin nga pozita "Zëvendës Drejtor Menaxhues-Divizioni i Likuidimit" në bazë të Aktgjykimit P. Nr. 904/2013 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë të datës 27.05.2014, si dhe Aktgjykimit të Gjykatës së Apelit PA. 1 1166/2014 i datës 03.02.2015.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, përmes vendimit A/02/154/2016, të datës 20.06.2016, ankuesit Naim Avdiu i ka refuzuar ankesën duke e lenë në fuqi, vendimin me numër protokolli Ref-Bd-72/3 të Bordit të Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 25.02.2016.

Gjykata Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Admirativë, me datë 15.11.2019, me An. 2060/2019, ka nxjerr Aktgjykim me të cilin aktgjykim ka refuzuar kërkesë paditen e paditësit lidhur me vendimin An. Nr. 02/154/2016, të datës 20.06.2016, të Këshillit për ankuesit vendimin me numër protokolli Ref-Bd-72/3, i datës 25.02.2016, të Bordit të Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Gjykata e Apelit e Kosovës, me datë 19.05.2022, ka nxjerr Aktgjykim A. Nr. 600/2020, me të cilin aktgjykim ka refuzuar ankesën e ankuesi si të pa themelet, duke e vërtetuar Aktgjykimin A. A. Nr. An. 2060/2019, të Gjykatës Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative të datës 15.11.2019.

Ankuesi me datë 11.08.2022, me numër protokolli 4654/2022, ka parashtruar ankesë Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër vendimit të datës 04.07.2022, i Bordit të Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (me tej KPMSHCK) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 18.08.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankese të Agjencia Kosovare e Privatizimit. Ndërsa me datë 30.08.2022, KPMSHCK-ja ka pranuar përgjigjen në ankese në bashku me shkresat lidhur me çështjen në procedurë.

**Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, ka administruar këto prova:** Ankesën A nr.698/2022, e datës 11.08.2022, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 04.04.2022, i Bordit të Drejtoreve; Aktvendimi A. Nr. 127/16, i datës 02.03.2022, i Gjykatës Themelore në Mitrovicë; Njoftimi i datës 02.03.2016; Vendimi i datës 25.02.2016; Aktgjykimi PKR, i datës 04.02.2022, i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Vendimi i datës 07.05.2014; Vendim i datës 31.08.2014; Vendimi i datës 07.05.2014; Aktgjykimi P. NR. 904/13, i Gjykatës Themelore në Prishtinë; Njoftimi i datës 22.09.2014, për vazhdimin e pezullimit; Vendimi i datës 02.12.2014, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi A. Nr. 661/2014, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendimi i datës 25.02.2016; Njoftimi i datës 02.03.2016; Ankesa e datës 16.03.2020, drejtor Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi i datës 24.03.2018, i Komisionit për Zgjidhjen e Kontesteve dhe Ankesave; Vendimi A. Nr. 02/154/2016, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kontrata e punës e datës 04.01.2013; Përgjigje në ankese e datës 30.08.2022, me numër protokolli 524/2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *është e pa bazuar sepse:*

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, na bazë të provave të administruara të lëndës ka konstatuar se ankuesi me datë 05.04.2022 ka parashtruar kërkesë në Agjencinë Kosovare të Privatizimit për kthimin e tij në vend e punës të cilin e ka mbajtur para se t'i

ndërpritet marrëdhënia e punës si dhe kompensimin e pagave në mënyrë retroaktive, me pretendimet se Gjykata Supreme e Kosovës me datë 20.09.2016 ka nxjerrë Aktgjykimin Pml nr.128/2016 përmes të cilit janë anuluar Aktgjykimi P. Nr. 904/2013 të Gjykatës Themelore në Mitrovicë të datës 27.05.2014 si dhe Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës PA1 nr.1376/2015 të datës 26.01.2016, përmes të cilave aktgjykime ankuesi ishte dënuar, ndërsa lënda është kthyer në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë dhe pastaj Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti për Krime të Rënda me datë 02.03.2022 ka nxjerr Aktvendimin P.nr.127/2016 përmes të cilit ka vendosur që të pushohet procedura penale ndaj ankuesit për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale.

Po ashtu Kolegji i Këshillit ka gjetur se, Kryesuesi i Bordit të Drejtoreve i Agjencisë Kosovare të Privatizimit përmes vendimit Ref BD-166/64 të datës 04.07.2022, ankuesit i ka refuzuar kërkesën lidhur me Vendimit Nr. Ref. BD -72/3, të datës 25.02.2016, duke refuzuar edhe kërkesën për kompensimin e pagave në mënyrë retroaktive nga data 25.02.2016 kur të njëjtit i është ndërprere marrëdhënia e punës, dhe po ashtu duke i refuzuar edhe kërkesën për kompensimin e pagave nga data 07.05.2014 deri me datën 25.02.2016 për kohën sa ishte i pezulluar me 50% të pagës derisa të njëjtit i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me ligjshmërinë e pretendimeve ankimore të ankuesit i cili pretendon se Vendimit Ref BD-166/64 Kryesuesi i Bordit të Drejtoreve i Agjencisë Kosovare i datës 04.07.2022 është i kundërligjshëm me faktin se Gjykatat Supreme e Kosovës i ka prishur Aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës si dhe Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në Mitrovicë të cilat kanë shërbyer si bazë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ndërsa shkalla e parë gjegjësisht Gjykata Themelore në Mitrovicë e ka pushuar procedurën penale ndaj ankuesit për shkak të parashkrimit absolut të ndjekjes penale, andaj Kolegji i Këshillit thekson faktin se Gjykata e Apelit të Kosovës përmes Aktgjykimit AA.nr.600/20 të datës 19.05.2022 e ka refuzuar ankesën e ankuesit si të pa themeltë ndërsa e ka lënë në fuqi dhe vërtetuar Aktgjykimin A.nr2060/2019 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 15.11.2019, gjegjësisht është konfirmuar edhe vendimmarrja e Këshillit përmes Vendimit A/02/154/2016 të datës 20.06.2016 si e rregullt dhe e bazuar në ligj me rastin e lënies në fuqi të Vendimit Nr. Ref. BD -72/3 të Kryesuesit të Bordit të Drejtoreve të Agjencisë Kosovare të Privatizimit të datës 25.02.20216 përmes të cilit ankuesit i është ndërprerë marrëdhënia e punës.

Po ashtu, Kolegji i Këshillit, thekson faktin se Gjykata e Apelit të Kosovës me rastin e nxjerrjes së Aktgjykimit AA.nr.600/20 të datës 19.05.2022 me rastin e refuzimit të padisë së paditësit Naim Avdiu si të pa themeltë, m në bazë të përmbajtjes së arsytimit lenë të nënkuptohet se ka qenë e njoftuar me gjendjen faktike, citoj: *".. Sa i përket arsytimit të gjykatës së shkallës së parë në lidhje me aktvendimin penal është pushuar procedura penale ndaj paditësit për shkak të parashkrimit apsolut të ndjekjes penale dhe nuk është vërtetuar përgjegjësia e tij gjykatat e Apelit vlerëson se sipas dispozitës së nenit 14 të LPK-së përcaktohet se: "Në procedim kontestimore gjykatat në pikëpamje të ekzistimit të veprës penale dhe të përgjegjësisë penale të kryerësit është e lidhur me aktgjykimin e formës së prerë të gjykatës penale me të cilin i pandehuri është shpallur fajtor" dhe në rastin konkret nga aktgjykimi penal paditësi është dënuar, mirëpo aktgjykimi është prishur dhe lënda është kthyer në rigjykim në shkallën e parë dhe në ndërkohë ka arritur parashkrimi apsolut i veprës penale dhe mbi këtë bazë nuk është arritur të vërtetohet ose jo përgjegjësia penale e paditësit për shkak të parashkrimit apsolut të ndjekjes penal", andaj mbi këtë bazë meqenëse Gjykata së Apelit të Kosovës me rastin e*


nxjerrjes së Aktgjykimit AA.nr.600/20 me datë 19.05.2022 ka qenë e njohur me rrethanat e krijuara, ndërsa ka lënë në fuqi dhe vërtetuar Aktgjykimin A.nr.2060/2019 e Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 15.11.2019, gjegjësisht është konfirmuar edhe vendimmarrja e Këshillit përmes vendimit A/02/154/2016 e datës 20.06.2016, Kolegji i Këshillit e refuzon si të bazuar ankesën e ankuesit të datës 11.08.2022 ndërsa mbetet në fuqi Vendimi i datës 04.07.2022, i Bordit të Drejtoreshave të Agjencisë Kosovare të Privatizimit si në dispozitiv të këtij vendimi.


Andaj, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar nën 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi

**KËSHILLI I PAVARUR MBIQËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
*Lënda me numër A.nr. 698/2022*

  
Ruskit KAJTAZI  
Procesmbajtës

  
Eshref SHABANI  
Kryetar i Kolegjit



Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit Menaxhues të Agjencisë Kosovare të Privatizimit;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

